

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XXIV, nr. 7112  
E enjte, 8 shkurt 2024  
Çmimi 0.50

Ratifikimi i marrëveshjes me Kosovën, Manastirliu: 30 bursa për studentët e Kosovës | FAQE 9



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

## PRELEC: KA GJASA QË KOSOVA TË THEMELOJË NJË ASOCIACION BOSH OSE FARE

FAQE 4-5



Marko Prelec nga Grupi Ndërkombëtar i Krizave ka theksuar se në situatën aktuale siç janë gjërat tani, ose nuk do të kemi asociacion, ose do ta kemi një sa për të thënë, që do të jetë një institucion bosh, të cilin

Qeveria e Kosovës do ta krijojë në mënyrë të njëanshme, pa asnjë përpjekje reale për t'i plotësuar nevojat e komunitetit që supozohet se duhet ta ndihmojë. Në intervistën dhënë për "Radion Evropa e Lirë", Prelec ka pohuar se

Perëndimi fiton relativisht pak nga vendosja e masave ose sanksioneve kundër Kosovës. Ai thotë se një nga gjërat me të cilat po përballen ShBA-ja dhe Bashkimi Evropian është ndikimi i kufizuar i tyre në Kosovë


STANO: KOSOVA RREZIKON TË MBETET PRAPA NË RRUGËN DREJT BE-SË PËR SHKAK TË VEPRIMEVE TË NJËANSHME | F.7



KRIMET E LUFTËS, 23 AKTAKUZA TË NGRITURA PËR TRE VJET | F.7



### AKTUALE



DHOMA E PËRFAQËSUESVE S'E MIRATON PROJEKTLIGJIN PËR NDIHMË VETËM PËR IZRAELIN | F.2

HOXHAJ: KURTIN E KANË MBAJTUR SHPESH NË ATHINË ME QËLLIM QË TA LARGOJNË PREJ TURQISË | F.3

KOMISIONI PËR ADMINISTRATË PUBLIKE I JEP MBËSHTETJE PROJEKTLIGJIT PËR KPM-në | F.3

### EKONOMI



RREGULLORJA E RE E BQK-SË, RASHIQI TAKON GUVERNATORIN ISMAILI: JEMI NË PERIUdhË TRANZICIONI | F.8

DOGANA KAP MBI 13 MIJË EURO TË PADEKLARUARA NË BËRNJAK | F.8

### SPORT



SONTE PËRBALLEN PEJA - BASHKIMI | F.10

**RENOVA**  
PUTZ  
Maqedoni  
Xhepçisht - Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@t.net.mk](mailto:renova@t.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegji.biznesi.com](http://www.kolegji.biznesi.com)  
info@kolegji.biznesi.com  
030 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...



## Dhoma e Përfaqësuesve s'e miraton projektligjin për ndihmë vetëm për Izraelin

WASHINGTON, 7 SHKURT - Dhoma e Përfaqësuesve nuk e ka kaluar një projektligj të mërkurën, sipas të cilit, Shtetet e Bashkuara do ta ndihmonin Izraelin me 17.6 miliardë dollarë, pasi demokratët thanë se duan një projektligj ku do të përfshihej edhe ndihma për Ukrainën, financimi ndërkombëtar humanitar dhe ndihma e re financiare për sigurinë kufitare.

Projektligji i mori 250 vota në favor dhe 180 kundër, duke dështuar të kalojë për shkak se u hodh në votim me procedurë të përshpejtuar, gjë që kërkonte dy të tretat e shumicës për të kaluar.

Ndihma për Izraelin - njërin prej vendeve të huaja që gëzon mbështetjen më të madhe amerikane - tradicionalisht ka marrë përkrahje të fuqishme dypartiake në Kongres. Por, shumë kundërshtarë e cilësuan legjislacionin e Dhomës së Përfaqësuesve si dredhi politike nga republikanët për ta shpërqendruar vëmendjen nga kundërshtimi i tyre ndaj një projektligji prej 118 miliardë



dollarësh, i cili përfshin një ndryshim të politikës amerikane për emigracionin dhe mbështetjen e re financiare për sigurinë kufitare, miliarda dollarë ndihmë emergjente për Ukrainën, Izraelin dhe partnerët në rajonin Indo-Paqësor. Kryetari i Dhomës së Përfaqësuesve, republikani Mike Johnson, kishte thënë se

projektligji i Senatit mbërriti "i vdekur" në Dhomë, edhe para se të paraqitej. Liderët republikanë të Senatit nuk kishin pritur që projektligji të merrte vota të mjaftueshme. "Me këtë nuk arrihet asgjë dhe vetëm vonohemi për t'u dërguar ndihma aleatëve tanë. Aleatët tanë po përballen me kërcënime ekzistenciale dhe

miqtë dhe armiqtë tanë nëpër botë po shikojnë, duke pritur ta shohin se si do të përgjigjet Amerika", tha Rosa DeLauro, demokratja e Komisionit të Dhomës së Përfaqësuesve për Ndarje Buxhetore, duke bërë thirrje që projektligji vetëm për Izraelin të mos votohej. Presidenti amerikan, demokrati Joe Biden, i cili e mbështet

projektligjin e Senatit, ishte zotuar se do të përdorte veto ndaj projektligjit të republikanëve për ndihmë vetëm për Izraelin në Dhomën e Përfaqësuesve.

Anëtarët e Kongresit janë duke hasur në vështirësi tash e disa muaj për ta gjetur një mënyrë se si të dërgojnë ndihma të sigurisë jashtë vendit, posaçërisht në Ukrainë, e cila është duke i luftuar pushtuesit rusë. Bideni i ka dërguar dy herë kërkesa Kongresit për projektligje të shpenzimeve emergjente, së fundmi në tetor. Dhoma e Përfaqësuesve, ku republikanët e kanë shumicën, e kaloi një projektligj për ndihma vetëm për Izraelin në nëntor, por ai projektligj nuk u dërgua kurrë në Senatin e udhëhequr nga demokratët, sepse negociatorët punuan në kërkesën e Bidenit për një pako më të gjerë për siguri emergjente dhe kërkesat republikane që secila ndihmë e sigurisë të kombinohet me ndryshime në politikën e emigracionit dhe sigurisë në kufi me Meksikën.

## Hamasi përgjigjet ndaj planit për armëpushim në Gazë

GAZA, 7 SHKURT - Grupi palestinez Hamas, i shpallur organizatë terroriste nga Shtetet e Bashkuara dhe Bashkimi Evropian, është përgjigjur ndaj një propozimi për një marrëveshje për armëpushim dhe lirim të pengjeve.

Përgjigjja e grupit radikal palestinez është publikuar në një media libaneze.

Dokumenti, autenticiteti i të cilit është konfirmuar nga zyrtarët, ofron pamjen më të qartë deri më tani të kërkesave të grupit radikal në këmbim të liritimit të më shumë se 100 pengjeve që po mban në Gazë. Përgjigjja ndaj planit të hartuar nga Shtetet e Bashkuara, Izraeli, Katari dhe Egjipti, parasheh një marrëveshje prej tri fazash, që do të zbatohet në një periudhë prej katër muajsh e gjysmë, duke çuar drejt fundit të luftës dhe liritimit të të gjitha pengjeve.

Propozimi i Hamasit në mënyrë efektive do të linte në pushtet në Gazë grupin radikal dhe do t'i mundësonte që t'i rindëronte aftësitë e tij ushtarake, një skenar që Izraeli e refuzon me vendosmëri.

Në fazën e parë prej 45 ditësh, Hamasi do t'i lironte gratë dhe fëmijët e mbetur, por edhe burrat e moshuar dhe ata të sëmurë, në këmbim të liritimit të të gjitha grave, fëmijëve, të sëmurëve dhe të



burgosurve të moshuar që mbahen nga Izraeli. Izraeli do të lironte edhe 1 500 të burgosur palestinezë, përfshirë edhe 500 persona, që Hamasi specifikisht kërkon lirim të tyre, që me gjasë janë luftëtarë të grupit radikal të profilit të lartë, të cilët po qëndrojnë në burgjet izraelite të dënuar me burgim të përjetshëm.

Izraeli do t'i tërhiqte forcat e tij nga qendrat e populluara, do t'i ndalte operacionet ajrore dhe do të lejonte që në Gazë të dërgohej më shumë ndihmë humanitare dhe të niste rindërtimi. Po ashtu, propozimi

parasheh që personat e zhvendosur të lejohen të kthehen në shtëpitë e tyre, përfshirë në veri të Gazës, dhe të hapen të gjitha vendkalimet.

Në fazën e dytë, e cila do të negociohej teksa do të zhvillohej faza e parë, Hamasi do t'i lironte pengjet e mbetura, kryesisht ushtarë dhe burra civilë, në këmbim të liritimit të më shumë pengjeve dhe Izraeli do ta kompletonte tërheqjen nga Gaza. Të dyja palët do t'i këmbenin pengjet e vrara dhe të burgosurit e vrarë gjatë fazës së tretë, e cila do ta

hapte rrugën për një armëpushim afatgjatë.

Një zyrtar i Hamasit dhe dy zyrtarë të Egjiptit konfirmuan autenticitetin e dokumentit të publikuar nga gazeta në Liban, Al-Akhbar, raporton Associated Press. Kjo gazetë libaneze është e afërt me grupin libanez, Hezbollah, që është aleat i Hamasit.

Sekretari amerikan i Shtetit, Antony Blinken, u takua me udhëheqësit izraelitë për t'i informuar për zhvillimet rreth një marrëveshjeje armëpushimi, pasi Hamasi

shpallosi planin për këtë çështje. Kryeministri izraelit Benjamin Netanyahu ka deklaruar se lufta do të vazhdojë deri në "fitoren e plotë" ndaj Hamasit dhe rikthimin e të gjitha pengjeve të mbetura.

Blinken, i cili po zhvillon vizitën e pestë në rajon që kur nisi lufta më 7 tetor, po tenton ta avancojë arritjen e një armëpushimi në Gazë dhe normalizimin e raporteve mes Arabisë Saudite dhe Izraelit në këmbim "të një rruge të qartë dhe të besueshme drejt themelimit të një shteti palestinez".

Netanyahu kundërshtoi fuqishëm shtetësinë palestineze.

Lufta në mes të Izraelit dhe Hamasit - që është konflikti më vdekjeprurës mes palëve në histori - nisi pasi Hamasi kreu sulm më 7 tetor në jug të Izraelit, duke vrarë afër 1 200 persona dhe duke rrëmbyer afër 250 të tjerë.

Izraeli u kundërpërgjigj me një ofensivë tokësore, ajrore dhe detare në Rripin e Gazës, shtëpi e 2.3 milionë palestinezëve. Sipas Ministrisë së Shëndetësisë në Gazën e udhëhequr nga Hamasi, deri më tani janë vrarë mbi 27 000 palestinezë. Kjo ministri nuk bën dallimin mes civilëve dhe luftëtarëve të vrarë, por ka thënë se shumica e viktimave ishin gra dhe fëmijë.



# Ratifikimi i marrëveshjes me Kosovën, Manastirliu: 30 bursa për studentët e Kosovës

EPOKA  
ERE

Faton DËRMAKU

TIRANË, 7 SHKURT - Qeveria e Shqipërisë ka miratuar Projektligjin për ratifikimin e marrëveshjes së bashkëpunimit në fushën e arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor ndërmjet ekzekutivit shqiptar dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Ratifikimi i kësaj marrëveshje përparon bashkëpunimin dypalësh dhe hap rrugën për ndërtimin e urave të reja të njohurisë dhe inovacionit në fushën e arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor. "Kjo është një marrëveshje e cila do të ratifikohet në Kuvendin e Shqipërisë dhe përcakton një seri bashkëpunimesh dhe partneritetesh me Ministrinë e Arsimit Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit të Kosovës dhe Ministrinë e Arsimit dhe Sportit të vendit tonë. Palët, të cilat janë në këtë marrëveshje, inkurajojnë dhe mbështesin bashkëpunimin në mes të komuniteteve akademike dhe do të thellohet bashkëpunimi duke inkurajuar pjesëmarrjen në projekte të përbashkëta të BE-së dhe në programet e UNESCO apo programe të tjera të cilat kanë

interes dypalësh", ka thënë ministrja e Arsimit, Ogerta Manastirliu, menjëherë pas përfundimit të mbledhjes së qeverisë.

Nëpërmjet kësaj marrëveshjeje qeveritë e të dyja vendeve lehtësojnë lëvizshmërinë e studentëve duke ofruar bursa për studime nga Shqipëria dhe Kosova. Kjo do të ndihmojë në eliminimin e barrierave financiare për studentët dhe do të ndihmojë në rritjen e bashkëpunimit mes institucioneve arsimore të dy vendeve. "Një tjetër risi që vjen nga kjo marrëveshje është programi i lëvizshmërisë së studentëve, ku do të mundësohet dhënia e bursave. Dhe do të jenë studentë të Kosovës, por edhe të Shqipërisë, sepse kjo është një marrëveshje reciproke, ku do të mundësohet dhënia e 30 bursave në vit për studentë në cikle të ndryshme studimi, që do të duan të studiojnë në Shqipëri në programe të ndryshme. Do të ketë një proces vlerësimi nga njësitë e arsimit të lartë dhe komisionet ad-hoc, të cilat do t'i përcaktojnë kriteret dhe procedurat për sa i përket përfitimit të bursave që parashikon kjo marrëveshje", ka thënë Manastirliu.



## Hoxhaj: Kurtin e kanë mbajtur shpesh në Athinë me qëllim që ta largojnë prej Turqisë

PRISHTINË, 7 SHKURT - Ish-ministri i Punëve të Jashtme, Enver Hoxhaj, ka thënë se kryeministri Albin Kurti ka pasur vizita shumë të shpeshta në Greqi, duke theksuar se një gjë të tillë nuk e ka bërë edhe në vendet e tjera të rajonit, si Shqipëri, Maqedoni e Veriut apo Bullgaria.

Hoxhaj ka thënë se Kurti është vënë në kurth kur është ftuar në vizita e simpoziume të shpeshta në Greqi, duke pohuar se qëllimi i tyre ka qenë mbajtja larg prej Turqisë. "Mendoj se është mirë që Kurti ka ndërtuar gjithashtu raporte të mira me Greqinë. Kemi pasur edhe ne sa kemi qenë në qeveri, edhe kryeministri Thaçi dhe të tjerët. Unë kam raporte shumë të mira me Greqinë, por Kurtin e kanë mbajtur shpesh në Athinë me qëllim që ta largojnë prej Turqisë dhe ai shpesh nuk e ka kuptuar mënyrën se si funksionon politika rajonale e



shteteve. Në politikë të jashtme ka edhe kapak kurthe të vogla edhe prej atyre të cilët presin. Unë nuk e kam pritur që Greqia e njej pavarësinë e Kosovës. Kam dëshirë që kjo të ndodh, por këtë e them me një arsye se nëse ju dhe unë jetojmë në një lagje të Prishtinës dhe unë vazhdimisht shkojë te fqinjët e tjerë dhe nuk vij asnjëherë te ju për kafe, nuk ka nevojë të kesh dije në diplomacinë politike. Kështu që shumë shpesh e kanë mbajtur me konferenca, simpoziume, ftesa të shpeshta për të treguar që është shumë afër Athinës dhe më larg të tjerëve. Në bindjen time kur je ministër i jashtëm si zonja Gërvalla, nëse Kurti s'e di, Gërvalla duhet t'ia shpjegojë. Nëse shkon pesë herë në Greqi duhet të shkosh katër ose pesë herë edhe në Shqipëri, Maqedoni të Veriut dhe në Bullgari", ka thënë Hoxhaj për "Tëvë1".

## Janjeva së shpejti destinacion turistik

PRISHTINË, 7 SHKURT - Ministria e Kulturës ka njoftuar se Janjeva së shpejti do të jetë destinacion turistik. "Projekti për rrijetësimin e qytetit të vjetër të Janjevës po vazhdon sipas planifikimeve. Aktualisht po punohet në restaurimin e 14 shtëpive dhe paralelisht në fuqizimin e kapaciteteve

lokale për ofrimin e shërbimeve cilësore turistike. Tashmë është publikuar platforma Janjeva Tourism, një platformë inovative për zhvillimin e turizmit rural që ka për qëllim promovimin e trashëgimisë kulturore dhe natyrore të Janjevës", ka njoftuar MKRS-ja.

Sipas këtij njoftimi, vlera totale e investimit në këtë projekt që synon shndërrimin e Janjevës në destinacion të rëndësishëm turistik është rreth 3.8 milionë euro.

Projekti është bashkëfinansim mes MKRS-së, Bashkimit Evropian dhe partner zbatues është UNDP-ja.







# Prelec: Ka gjasa që Kosova të themelojë një asociacion bosh ose fare

Marko Prelec nga Grupi Ndërkombëtar i Krizave ka theksuar se në situatën aktuale siç janë gjërat tani, ose nuk do të kemi asociacion, ose do ta kemi një sa për të thënë, që do të jetë një institucion bosh, të cilin Qeveria e Kosovës do ta krijojë në mënyrë të njëanshme, pa asnjë përpjekje reale për t'i plotësuar nevojat e komunitetit që supozohet se duhet ta ndihmojë. Në intervistën dhënë për "Radion Evropa e Lirë", Prelec ka pohuar se Perëndimi fiton relativisht pak nga vendosja e masave ose sanksioneve kundër Kosovës. Ai thotë se një nga gjërat me të cilat po përballen ShBA-ja dhe Bashkimi Evropian është ndikimi i kufizuar i tyre në Kosovë

**PRISHTINË, 7 SHKURT** - Marko Prelec nga Grupi Ndërkombëtar i Krizave thotë se vendimi që e ndalon përdorimin e dinarit serb në Kosovë do të duhej të negociohej në bisedimet në mes të Kosovës dhe Serbisë që i ndërmjetëson Bashkimi Evropian. Sipas tij, dinari "nuk është vetëm një monedhë - për të mirë ose për të keq, komuniteti serb varet prej tij". Duke folur për "Radion Evropa e Lirë", ai thotë se vendimi për të,

ashtu si dhe mbyllja e disa komunave paralele serbe në Kosovë, do ta ndikojnë Asociacionin e Komunave me Shumicë Serbe që pritet të formohet. "Ashtu siç janë gjërat tani - ose nuk do të kemi asociacion, ose do ta kemi një sa për të thënë, që do të jetë një institucion bosh, të cilin qeveria do ta krijojë në mënyrë të njëanshme, pa asnjë përpjekje reale për t'i plotësuar nevojat e komunitetit që supozohet se

duhet ta ndihmojë. Dhe, kjo është për keqardhje", thotë Prelec.

Ai, po ashtu, thekson se ShBA-ja dhe Bashkimi Evropian po përballen me ndikim të kufizuar në Kosovë.

*Z. Prelec, si i shihni veprimet e fundit të autoriteteve të Kosovës për të miratuar një rregullore që e ndalon përdorimin e dinarit serb në Kosovë, si dhe për mbylljen e disa komunave paralele serbe?*

**Marko Prelec:** Mendoj se Qeveria e Kosovës po lëviz më shpejt se që prisja prej saj, po lëviz në atë drejtim që e ka synuar për ca kohë e që ka qenë vendosja e rendit juridik të Kosovës në gjithë territorin e saj dhe heqja e pjesëve të mbetura të Serbisë, që janë të pranishme në mënyrë substanciale në komunat në veri, por në një lloj mënyre edhe në disa zona të tjera me shumicë serbe.

*Si e komentoni faktin që edhe 25*

*vjet pas luftës përdoret dinari dhe funksionojnë edhe institucionet serbe?*

**Marko Prelec:** Po e shohim zgjidhjen tani. Është zgjidhje e njëanshme, që do ta bëjë të pamundshëm përdorimin e dinarit...

*Ka pasur reagime të ashpra nga komuniteti ndërkombëtar...*

**Marko Prelec:** Mendoj se sfondi i atyre reagimeve të ashpra, të cilat janë krejtësisht të kuptueshme, është se këto gjëra janë jashtëzakonisht të rëndësishme për komunitetin serb në Kosovë, si në veri ashtu edhe në jug. Ata varen në mënyrë ekzistenciale nga institucionet serbe. Nëse ato i largoni brenda natës, ata njerëz, shumica dërrmuese, mendoj se do të kishin pak mundësi të tjera, veçse të përpiqen të largohen. Megjithatë, dua të jem i kujdesshëm këtu - Qeveria e Kosovës, duke bërë atë që po bën, nuk po përpiqet t'i dëbojë serbët. Mendoj se nuk ka asnjë shenjë

për këtë. Por, efekti i asaj që bën, çon në tkurrje të komunitetit. Kjo mund të ketë pasoja shumë fatale për karakterin multi-etnik të Kosovës dhe për shpresat e saj për marrëdhënie të përmirësuara me Serbinë, si dhe për integrim të plotë në komunitetin ndërkombëtar. Mendoj se këto shqetësime janë në thelb të reagimeve të miqve perëndimorë të Kosovës.

*Atëherë, si do të duhej të vepronte Qeveria e Kosovës, sipas jush?*

**Marko Prelec:** Mendoj se nuk është mënyra e duhur. Jam dakord me shqetësimet e shprehura nga Ambasada amerikane dhe të tjerët. Por, mendoj se e kuptoj llogaritjen që është bërë edhe në Prishtinë. Ata, thjesht, nuk besojnë se, nëse e trajtojnë komunitetin serb me një shkallë fleksibiliteti dhe zemërgjerësie dhe i ofrojnë një shkallë të vetëqeverisjes, në këmbim do të marrin



# Gërvalla para deputetëve italianë flet për agresionin e 24 shtatorit, kërkon veprime ndaj rrezikuesve të paqes

PRISHTINË, 7 SHKURT - Progresi i arritur në sundim të ligjit, demokratizim, avancim të të drejtave të njeriut, në veçanti të të drejtave të komuniteteve joshumicë, bashkëpunimi rajonal në siguri, zhvillim ekonomik dhe integrim euroatlantik, ishin disa nga temat e takimit që zëvendëskryeministrja dhe Ministrja e Punëve të Jashtme dhe e Diasporës, Donika Gërvalla, pati me kryetarin e Komisionit për Punë të Jashtme nga Dhoma e Deputetëve në Itali, Giulio Tremonti.

Ministrja Gërvalla e njoftoi kryetarin Tremonti dhe deputetët edhe për aktin e agresionit serb të 24 shtatorit në Banjskë dhe ritheksoi nevojën imediate për ndërmarjen e veprimeve kundër atyre që në vazhdimësi po



rezikojnë paqen dhe stabilitetin në Ballkanin Perëndimor.

Deputetët italianë shprehën interesimin e tyre rreth proceseve

nëpër të cilat po kalon Kosova, sfidat dhe vizionin e Qeverisë së

Kosovës për të ardhmen e saj integruese.

## Latifi kërkon që të rritet cilësia e shërbimeve shëndetësore në Rahovec



RAHOVEC, 7 SHKURT - Kryetari i komunës së Rahovecit, Smajl Latifi, ka mbajtur takimin e parë për vitin 2024 me punëtorët shëndetësorë. Ai ka bërë me dije se me punëtorët shëndetësorë kanë diskutuar për gjendjen e përgjithshme të shëndetësisë në komunën e Rahovecit, ekipin mobil të kujdesit shtëpiak, shërbimet pediatrike, shërbimet gjinekologjike, stomatologjike, laboratorët, gjendjen aktuale

të furnizimeve me barna esenciale, reagensë, materiale e pajisje të reja shëndetësore dhe format e tjera të përkrahjes së QKMF-së, rrjetit të QMF-ve dhe AMF-ve. "Po ashtu diskutuam për mundësitë e rritjes në vazhdimësi të cilësisë së shërbimeve dhe diskutuam për investimet kapitale që po bëhen dhe ato që planifikojmë t'i bëjmë në sektorin e shëndetësisë për

vitin 2024. Mirënjohës dhe falënderues për shërbimin dhe angazhimin e tyre për mbrojtjen e shëndetit të qytetarëve të Rahovecit! Së bashku, jemi në përpjekje të vazhdueshme për shtimin e shërbimeve të tjera dhe për rritjen e vazhdueshme të cilësisë së tyre. Shëndetësia është një prej sektorëve kryesorë në fokusin tonë", ka thënë Latifi.

normalizimin [e marrëdhënieve] me Serbinë. Ata nuk besojnë në qasjen "jep e merr". Nuk besojnë se Serbia sillet me ta në mirëbesim. Frika e tyre është se, nëse krijojnë një bashkësi autonome ose asociacion komunash të caktuara, Serbia do ta marrë atë dhe nuk do të bëjë asgjë. Kjo nuk është një frikë e paarsyeshme. E kuptoj, por, megjithatë, mendoj se është gabim.

*A mendoni se Kosova tani duhet ta shtyjë zbatimin e vendimit që e ndalon dinarin?*

**Marko Prelec:** Mendoj se duhet. Mendoj se kjo është diçka që duhet të ndodhë. Por, mendoj se është shumë më mirë nëse bëhet në mënyrë të negociuar përmes dialogut në Bruksel. Duhet një sistem që e zëvendëson atë që bën dinari. Dinari nuk është vetëm një monedhë, është gjithashtu një sistem i madh i pagesave serbe. Për të mirë ose për të keq, komuniteti serb varet prej tij. Pra, është shumë më mirë nëse bëhet në një mënyrë të planifikuar dhe të negociuar.

*Po, por Kosova nuk do kështu dhe ky është një tjetër shembull i refuzimeve të kryeministrit Albin Kurti - pas Asociacionit, targave... Këto refuzime në të kaluarën janë*

*përcjellë me masa të caktuara. A prisni tani masa të reja nga Perëndimi kundër Kosovës?*

**Marko Prelec:** Mendoj se Perëndimi fiton relativisht pak nga vendosja e masave ose sanksioneve kundër Kosovës. Mendoj se një nga gjërat me të cilat po përballen ShBA-ja dhe Bashkimi Evropian, është ndikimi i kufizuar i tyre në Kosovë. Ka ekzistuar për kohë të gjatë perceptimi se diplomatët perëndimorë, e veçanërisht ambasadori amerikan është një lloj sundimtari në Prishtinë. Për kohë të gjatë, askush nuk ka bërë përpjekje ta ndryshojë këtë. Kurti e ka bërë. Është fakt se ai është kryeministër i Qeverisë së Kosovës, ai ka fuqi dhe mund të bëjë çfarë të dojë. Unë nuk pres më tepër se përgjigje retorike. Kurse, Kosova ka të ngjarë ta paguajë çmimin duke mbetur në statusin e saj aktual ndërkombëtar për një të ardhme të parashikueshme.

*Por, udhëheqësit e Kosovës thonë se veprojnë në përputhje me Kushtetutën dhe ligjin...*

**Marko Prelec:** Po, edhe kanë të drejtë, por ligjshmëria nuk është masa e vetme apo më e mira në politikë. Ju duhet të vendosni se cila politikë ka më shumë gjasa t'ju çojë drejt qëllimeve tuaja dhe

si të veproni mirë për njerëzit që i përfaqësoni. Pra, Qeveria e Kosovës duhet të mendojë edhe për shumicën shqiptare, por edhe për pakicën serbe. Ata janë gjithashtu qytetarë të Kosovës, interesat e të cilëve mendoj se duhet të jenë më lart në agjendën e kryeministrit.

*A mendoni se ka qasje alternative apo kompromise që mund të përmbushin edhe Qeverinë e Kosovës, edhe pritjet e ShBA-së?*

**Marko Prelec:** Siç e thashë edhe më herët, Kurti nuk beson në qasjen "merr e jep". Ai nuk beson se do ta marrë nga Serbia atë që i është premtuar. Mendoj se ka ende arsye për të ecur përpara dhe për ta trajtuar komunitetin serb të Kosovës me më shumë zemërgjerësi dhe për t'i dhënë një shkallë më të madhe të vetëqeverisjes. Mendoj se kjo do të ishte mirë për Kosovën, për arsye të ndryshme.

Me vite të tëra e kam thënë dhe shumë njerëz e kanë thënë se ka shumë shembuj të autonomive territoriale në Bashkimin Evropian, dhe se shtetet që i kanë ato, nuk duket se vuajnë prej tyre. Në fakt, shtetet që kanë autonomi territoriale, janë disa nga më të pasurat, më të fuqishmet dhe më të qëndrueshmet brenda

Bashkimit Evropian. Pra, kjo mund të jetë një gjë e mirë për t'u bërë.

Ka edhe një aspekt tjetër këtu që duhet ta marrim parasysh. Sundimi i ligjit në Kosovë tashmë ka inkorporuar disa obligime ndaj komunitetit serb, përfshirë atë për themelimin e Asociacionit të komunave me shumicë serbe. Gjykata Kushtetuese e Kosovës ka konstatuar në vitin 2015 se disa parime të tij nuk kanë qenë në përputhje me frymën e Kushtetutës. Por, megjithatë, krijimi i Asociacionit ka qenë detyrim. Qeveria, thjesht, ka zgjedhur ta keqinterpretojë atë vendim. Qeveri të njëpasnjëshme kanë vepruar kështu. Pra, kjo është gjithashtu pjesë e përpjekjeve për sundim të ligjit brenda Kosovës.

*Sa mund ta ndikojnë mosmarrëveshjet aktuale për funksionimin e Asociacionit?*

**Marko Prelec:** Mendoj se në këtë pikë - ashtu siç janë gjërat tani - ose nuk do të kemi asociacion, ose do ta kemi një sa për të thënë, që do të jetë një institucion bosh, të cilin Qeveria do ta krijojë në mënyrë të njëanshme, pa asnjë përpjekje reale për t'i plotësuar nevojat e komunitetit që supozohet se duhet ta ndihmojë.

Dhe, kjo është për keqardhje. Në një tekst që ka publikuar së voni Grupi Ndërkombëtar i Krizave, ne kemi përmendur disa gjëra praktike që mund të bëhen dhe që, në asnjë mënyrë, nuk e ndikojnë sovranitetin dhe integritetin e Kosovës. Gjëra të tilla si legalizimi i institucioneve shëndetësore dhe arsimore serbe, do të ishin një ndihmë e madhe për komunitetin serb të Kosovës. Po ashtu, t'i jepet zë komunitetit për mënyrën se si qeveriset, përmes instrumenteve të ndryshme të pjesëmarrjes. BE-ja e ka kërkuar këtë, por, kohëve të fundit, duket se e ka harruar, sepse ai komunitet ndihet vërtet i braktisur si nga Prishtina, ashtu edhe nga Beogradi. Unë mendoj se kanë të drejtë të ndihen kështu, sepse askush nuk i dëgjon.

*Në dritën e këtyre ngjarjeve, si mund të reagojnë vendet fqinje në Ballkan?*

**Marko Prelec:** Mendoj se një prej gjërave që i befason dëgjuesit jashtë Ballkanit, është shkalla në të cilën vendet në atë rajon e injorojnë njëri-tjetrin. Ka shumë pak interes dhe njohuri për njëri-tjetrin, përveç gjërave si turizmi. I vetmi përjashtim deri diku janë komunitet etnike që gjenden në më shumë se një shtet.



## Totaj dhe Malaj diskutuan për forcimin e marrëdhënieve ndërkufitare

PRIZREN, 7 SHKURT - Kryetari i komunës së Prizrenit, Shaqir Totaj, ka takuar ambasadorin e Shqipërisë në Prishtinë, Petrit Malaj, me të cilin ka biseduar mbi strategjitë kryesore që synojnë nxitjen e lidhjeve më të forta ndërmjet rajoneve përkatëse dhe avancimin e përpjekjeve bashkëpunuese në sektorë të ndryshëm.

Gjatë takimit, Totaj dhe Malaj theksuan rëndësinë e forcimit të marrëdhënieve me komunat ndërkufitare të Shqipërisë për ta nxitur rritjen socio-ekonomike dhe shkëmbimin kulturor.

Të dy personalitetet nënvizuan rëndësinë e solidaritetit dhe bashkëpunimit në adresimin e sfidave të përbashkëta dhe shfrytëzimin e mundësive për zhvillim të ndërsjellë.

Temë diskutimi, gjithashtu, ishte



zgjerimi i iniciativave të turizmit, kulturës, sportit dhe arsimit ndërmjet Kosovës dhe

Shqipërisë. Duke njohur potencialin e jashtëzakonshëm në këto zona,

kryetari Totaj dhe ambasadori Malaj diskutuan për partneritete strategjike për ta forcuar infrastrukturën turistike, ruajtjen e trashëgimisë kulturore, promovimin e ngjarjeve sportive dhe pasurimin e shkëmbimeve arsimore midis dy vendeve.

Totaj shprehu optimizmin për përpjekjet e bashkëpunimit: "Ky takim shënon një hap të rëndësishëm drejt thellimit të lidhjeve tona me komunat kufitare të Shqipërisë dhe eksplorimit të rrugëve për rritje gjithëpërfshirëse. Duke përdorur vlerat dhe burimet tona të përbashkëta, ne mund ta hapim rrugën për një partneritet të mirë, nga i cili përfitojnë qytetarët e të dyja anëve".

Në anën tjetër, ambasadori Petrit Malaj ka theksuar rëndësinë e sinergjisë dhe

bashkëpunimit ndërkufitar: "Jam tejet i lumtur për takimin e sotëm me z. Totaj, një person me kaq energji pozitive, interaktiv e i gatshëm për të hedhur hapa konkretë në këtë çështje. Shqipëria dhe Kosova ndajnë një histori të pasur dhe afinitete kulturore. Është e domosdoshme që ta shfrytëzojmë këtë lidhje për t'i çuar përpara vendet tona, veçanërisht në fusha të tilla si turizmi, kultura, sporti dhe arsimit, të cilat kanë potencial të jashtëzakonshëm për nxitjen e prosperitetit dhe unitetit".

Takimi përfundoi me rikonfirmimin e të dyja palëve për angazhimin e tyre për t'i shtyrë më tej marrëdhëniet dypalëshe dhe zbatimin e nismave të bashkëpunimit për të mirën e qytetarëve.

## Komisioni për Administratë Publike i jep mbështetje projektligjit për KPM-në

PRISHTINË, 7 SHKURT - Komisioni për Administratë Publike ka votuar në parim Projektligjin për Komisionin e Pavarur të Medieve. Në këtë takim ka raportuar zëvendëskryeministri i parë, Besnik Bislimi. Ai ka folur edhe për direktivat e BE-së që jep prerogativat e përcaktuara për Komisionin e Pavarur të Medieve, si institucion i pavarur për mbikëqyrjen e tregut medial në Kosovë, siç është përcaktuar edhe me Kushtetutën e vendit tonë, raporton Ekonomia Online.

Bislimi lidhur me këtë projektligj bëri me dije se cilat

shërbime bien mbi domenin e Komisionit të Pavarur të Medieve. Ai më tej sqaroi se direktiva e BE-së lidhur me këtë projektligj, nënkupton një obligim që e njëjta të transpozohet në të gjitha shtete evropiane. "Në këtë dritë direktiva thekson, mes të tjerash, përtej obligimit për transpozim që nuk mund të paragjykohej, shtetet anëtare mund ta ruajnë rregullimin aktual për aq kohë sa i njëjti funksionon në mënyrë efektive", tha ai.

Bislimi theksoi se që të fuqizohet liria e shprehjes dhe të

promovohet pluralizmi medial, duke iu shmangur edhe konfliktit të interesit, është me rëndësi që shfrytëzuesit të informacionit, qytetarët, të kenë qasje në informacion lidhur me pronarët e medieve. "Projektligji i Komisionit të Pavarur të Medieve


adreson rekomandimet që dalin nga raportet për vendin nga vitet e mëparshme dhe përafron legjislacionin tonë me atë të BE-së, siguron rregullat e barabarta të konkurrueshmërisë në treg, mbrohen shtresat e ndjeshme të shoqërisë, inkurajon transmetimin e programeve



edukative arsimore e shkencore, lajmin e saktë dhe kështu ndikon pozitivisht te publiku i

gjerë", ka thënë zëvendëskryeministri i parë, Besnik Bislimi.

## OIK-u themelon zyrën për licencim dhe rilicencim të psikologëve klinikë, logopedëve dhe ergoterapeutëve



PRISHTINË, 7 SHKURT - Oda e infermierëve, mamive dhe profesionistëve të tjerë shëndetësorë ka hapur zyrën për licencim dhe rilicencim të psikologëve klinikë, logopedëve dhe ergoterapeutëve.

Udhëheqëse e kësaj zyre është zgjedhur Donika Shahini-Lami, psikologe me përvojë shumëvjeçare, e cila deri më tani ka qenë pjesë e komisioneve të rëndësishme të OIK-ut.

Zyra për licencim dhe rilicencim të psikologëve klinikë, logopedëve dhe ergoterapeutëve do të asistojë dhe do t'u japë ndihmë psikologëve klinikë, komisioneve për licencim të psikologëve klinikë si dhe bazuar në planin e punës harton raporte periodike për zyrën. Po ashtu, kjo zyrë koordinon edukimin e vazhdueshëm profesional dhe inicion tek

organet e OIK-ut të gjitha propozimet në lidhje me aktet normative për licencim dhe rilicencim të psikologëve klinikë.

Zyra do të bashkëpunojë me njësitë e tjera organizative të shërbimit profesional dhe administrativ në çështjet që ndërlidhen me procedurat për licencim dhe rilicencim të psikologëve klinikë, logopedëve dhe ergoterapeutëve.

## Kalon në Komisionin për Ekonomi Projektligji "Evropa digjitale për periudhën 2021-2027" në mes të Kosovës dhe BE-së

PRISHTINË, 7 SHKURT - Komisioni për Ekonomi, Industri, Ndërmarrësi dhe Tregti, mbajti sot mbledhjen e radhës, nën drejtimin e kryetarit Ferat Shala. Gjatë kësaj mbledhjeje Komisioni shqyrtoi Projektligjin për ratifikimin e marrëveshjes

ndërkombëtare për pjesëmarrjen e Kosovës në programin e Bashkimit Evropian "Evropa digjitale për periudhën 2021-2027" ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian.

Projektligjin para komisionit e paraqiti dhe arsyetoi ministrija e Ekonomisë, Artane Rizvanolli. Pas diskutimeve komisioni i dha mbështetje projektligjit, duke i propozuar Kuvendit shqyrtimin e tij në seancën e nesërme si pikë shtesë.





## Krimet e luftës, 23 aktakuza të ngritura për tre vjet

PRISHTINË, 7 SHKURT - 23 aktakuza për krime luftarë janë ngritur nga viti 2020 deri në vitin 2023. Kështu është bërë me dije në diskutimin "Ngritja e kapaciteteve në hetimin dhe gjykimin e krimeve të luftës në Kosovë", organizuar nga Fondi për të Drejtën Humanitare. Amer Alija nga Fondi për të Drejtën Humanitare ka thënë se rekomandim i vazhdueshëm mbetet ngritja e kapaciteteve për hetimin e krimeve të luftës. Ndërsa prokurori special, Ilir

Morina, ka deklaruar se ngritja e kapaciteteve të institucioneve paraqet sfidë të vazhdueshme. Ai është shprehur se aktualisht po punojnë me tre prokurorë, pas pensionimit të prokurores speciale Drita Hajdari. "Ne po mundohemi t'i rrisim kapacitetet. Nga viti 2018 deri në vitin 2020 ka qenë një periudhë tranzitore për pranimin e lëndëve. Në vitin 2020 ka qenë pandemi. Ne vitin 2020 është miratuar strategjia për hetimin e krimeve të luftës, ku janë

caktuar katër prokurorë për hetimin e krimeve të luftës. Kemi filluar të pranojmë lëndë të reja. Sfidat e parë ka qenë që, përveç transferimit të lëndëve, nuk ka pasur transferim të praktikave, ka munguar përvoja dhe tani me ndihmën edhe të partnerëve ndërkombëtarë, kemi arritur të krijojmë një kapacitet të konsiderueshëm", ka thënë Morina. Më tutje, ai ka treguar edhe numrin e aktakuzave që janë ngritur nga periudha që kanë



marrë kompetencat për hetimin e krimeve të luftës. "Nga viti 2016 deri në vitin 2019 janë ngritur 12 aktakuza

ndaj 13 personave. Nga viti 2020 deri në fund të vitit 2023 janë ngritur 23 aktakuza ndaj 76 personave", ka thënë Alija.

## Stano: Kosova rrezikon të mbetet prapa në rrugën drejt BE-së për shkak të veprimeve të njëanshme

PRISHTINË, 7 SHKURT - Zëdhënësi i Bashkimit Evropian (BE), Petar Stano, ka thënë të mërkurën se Kosova rrezikon të mbetet prapa në rrugën e saj drejt anëtarësimit në bllok, për shkak të, siç i quajti ai, veprimeve në njëanshmi të saj. Ai i bëri thirrje Kosovës dhe Serbisë të përqendrohen në përmbushjen e detyrimeve që dalin nga marrëveshjet për të cilat janë pajtuar në dialogun e ndërmjetësuar nga BE-ja. Kosova është kritikuar vazhdimisht së fundmi nga BE-ja për shkak të vendimit të Bankës Qendrore të Kosovës për ta ndaluar përdorimin e dinarit serb për transaksione me para ta gatshme në gjithë vendin si dhe për mbylljen e disa komunave paralele serbe në Dragash dhe Pejë. BE-ja i ka quajtur të njëanshme këto vendime dhe ka kërkuar që Kosova t'i zgjidhë këto çështje në bisedime me Serbinë në dialogun e ndërmjetësuar nga ajo. "Po shohim shumë gjëra për të cilat kemi reaguar, sidomos në rastin e Kosovës, me veprime të njëanshme që kanë krijuar shqetësim për ne. Kjo krijon frikë në anën tonë se Kosova mund të mbetet jashtë dhe të mbetet prapa", tha Stano. Kosova aplikoi për anëtarësim në BE më 2022 dhe është vendi i vetëm nga Ballkani Perëndimor që ende nuk e ka fituar statusin e vendit kandidat. Rregullorja e BQK-së, e cila



kërkon që euroja të jetë valuta e vetme që mund të përdoret për pagesa me para të gatshme në gjithë vendin, hyri në fuqi më 1 shkurt, me gjithë trysninë e madhe ndërkombëtare për shtyrjen e zbatimit të saj.

Ministri për Komunitete dhe Kthim në Qeverinë e Kosovës, Nenad Rashiç, tha të mërkurën se gjatë një takimi me kryeministrin e Kosovës, Albin Kurti, janë pajtuar se rregullorja e BQK-së për ndalimin e dinarit

është në një periudhë tranzicioni. Vendimi për heqjen e dinarit në Kosovë përkon me mbylljen e komunave paralele që punojnë në sistemin serb dhe janë të paligjshme për Kosovën.

Në dy javët e fundit janë mbyllur katër komuna paralele serbe në Dragash dhe në Pejë. Stano tha se nuk sheh rrezik për bllokim të dialogut në mes të Kosovës dhe Serbisë, pavarësisht mungesës së përparimit në disa takimet e fundit. "Dialogu po vazhdon dhe po vazhdojmë për t'u ndihmuar palëve që më në fund të fillojnë të sillen në mënyrë konstruktive dhe ato të lëvizin përpara. Nuk kemi frikë nga ndonjë bllokadë, në fakt ne nuk kemi frikë nga asgjë. Por, vetëm kemi frikë që njerëzit në Kosovë dhe në Serbi të mbesin jashtë asaj që është për ta e rëndësishme - procesi i integritetit", theksoi Stano. Ai shtoi se "ne vazhdojmë punën tonë dhe përfaqësuesi i posaçëm, Miroslav Lajçak, si dhe përfaqësuesi i lartë Joseph Borrell janë duke vazhduar punën me partnerët, si me ata në rajon, ashtu edhe me ata në skenën ndërkombëtare, për të mundësuar të dyja palëve që të nisin të bëjnë hapa të cilat do t'u mundësonin avancim në të gjitha çështjet në dialog, sidomos në zbatimin e gjithë asaj që është arritur vitin e shkuar në Bruksel dhe në Ohër". Sipas BE-së, Kosova dhe Serbia arritën marrëveshjen për normalizimin e marrëdhënieve dhe Aneksit për zbatimin e saj në fillim të vitit 2023, por ato nuk janë duke u zbatuar pavarësisht prej trysnisë ndërkombëtare.

## Haxhiu takohet me homologun britanik: U rikonfirmua mbështetja e bashkëpunimit në fushën e drejtësisë

PRISHTINË, 7 SHKURT - Në kuadër të vizitës në Mbretërinë e Bashkuar, ministrja e Drejtësisë, Albulena Haxhiu, është takuar me sekretarin shtetëror për drejtësi, Lord Alex Chalk. Gjatë takimit, ministrja Haxhiu ka falënderuar Mbretërinë e Bashkuar për mbështetjen për reformën në drejtësi me fokus të veçantë vetingun, sundimin e ligjit dhe sigurinë.

Më tutje, ministrja Haxhiu foli për proceset që është duke ndërmarrë Ministria e Drejtësisë në kompletimin e reformës në drejtësi, luftimin e kontrabandës në burgje, adresimin e dhunës në familje dhe asaj me bazë gjinore etj. Ministrja Haxhiu dhe sekretari Lord Alex Chalk folën edhe për lidhjen e marrëveshjeve ndërmjet të dyja vendeve, të cilat kanë të

bëjnë me ekstradimin, transferimin e personave të dënuar por, gjithashtu, edhe për marrëveshjen për ndihmë të ndërsjellë juridike në çështjet penale. Ministrja Haxhiu falënderoi Lordin Alex Chalk për mbështetjen e vazhdueshme që Mbretëria e Bashkuar ka bërë për Kosovën dhe bashkërisht u zotua për thellim të bashkëpunimit ndërmjet dy vendeve.





## Dogana kap mbi 13 mijë euro të padeklaruar në Bërnjak

**BËRNJAK, 7 SHKURT** - Në pikëkalimin kufitar të Bërnjakut është ndalua një automjet, në të cilin është zbuluar një sasi e konsiderueshme e mjeteve monetare të padeklaruar. Pas ndaljes së automjetit nga oficerët doganorë, në bashkëpunim me Policinë e Kosovës, ata kanë kryer kontrollin e hollësishëm të automjetit.

Gjatë këtij kontrolli në çantën e drejtuesit të mjetit u zbulua një shumë e mjeteve monetare të

padeklaruar në lartësinë prej 13 350 eurosh.

Në përputhje me procedurat, 25 % e kësaj shume do të konfiskohet, që do të thotë një shumë prej 3 337.50 eurosh. “Kjo masë është ndërmarë si pasojë e shkeljes së rregullave të deklarimit monetar, ndërsa shuma e mbetur do t’i nënshtrohet një verifikimi të mëtejshëm në lidhje me origjinën e këtyre mjeteve monetare, në bashkëpunim me



sektorët kompetentë dhe në koordinim me prokurorinë. Dogana e Kosovës ka aplikacionin eDogana për pajisjet e mençura android dhe ios, i cili mundëson lajmërim të parregullsisve dhe sjelljeve joprofesionale me komunikim të sigurt dhe, gjithashtu, ofron shërbime të tjera me qëllim të shërbimit ndaj qytetarëve dhe komunitetit të prodhuesve dhe tregtisë në përgjithësi”, ka njoftuar Dogana e Kosovës.

# Rregullorja e re e BQK-së, Rashiq takon guvernatorin Ismaili: Jemi në periudhë tranzicioni



**EPOKA E RE** **Faton DËRMAKU**

**PRISHTINË, 7 SHKURT** - Guvernatori i Bankës Qendrore të Kosovës, Ahmet Ismaili, ka pritur në takim ministrin për Komunitete dhe Kthim, Nenad Rashiq.

Guvernatori Ismaili gjatë këtij takimi e ka njoftuar ministrin Rashiq për ndryshimet e fundit në Rregulloren për Operacione me Para të Gatshme, duke sqaruar aspektet kryesore, efektet dhe argumentet për pozicionin e saj.

Gjatë takimit, po ashtu, është diskutuar edhe për mundësitë ekzistuese, alternativat dhe qasjen në financa përmes kanaleve të ndryshme financiare të licencuara për operim në të gjithë territorin e Republikës së Kosovës.

Për më tepër, u sqarua se Rregullorja në fjalë nuk ndalon apo kufizon pranimin e mjeteve në llogaritë bankare në euro në bankat e licencuara dhe as nuk

kufizon aktivitetin këmbimor të cilësdo valutë që kryhen nga institucionet financiare bankare ose jobankare të licencuara nga BQK-ja.

Andaj, të gjithë individët kanë qasje në llogari bankare dhe mund të pranojnë mjete në llogaritë e tyre në euro përmes kanaleve të ndryshme ligjore.

Në takim u tha se të gjithë qytetarët që tashmë kanë një llogari bankare në euro, në cilëndo bankë të licencuar në Kosovë, mund ta përdorin të njëjtën për t’i pranuar mjetet nga çdo shtet. Ndërsa, ata që ende nuk kanë llogari, mund të hapin një të tillë tek secila bankë, sipas Rregullosës së BQK-së për Qasje në Llogari Pagese për Shërbime Bazike, që për grupet e cenueshme e të skemave sociale nuk ka tarifë të hapjes e as të mirëmbajtjes nga 1 janari 2024.

Gjithashtu, guvernatori Ismaili e njoftoi ministrin Rashiq se vetëm

në katër komunat veriore operojnë katër degë bankare, tri institucione mikrofinanciare (kredidhënëse) si dhe mbi 15 institucione financiare jobankare për pagesa dhe këmbimor.

Numri i degëve dhe i zyrave të institucioneve financiare që operojnë në atë zonë është në rritje, pasi përfshirja financiare është objektivi i BQK-së.

Guvernatori Ismaili tha se BQK-ja mbetet e vendosur për avancimin e kornizës ligjore dhe mbikëqyrëse në zbatimin e mandatit të saj kushtetues dhe se mbetet e përkushtuar t’i vazhdojë aktivitetet informuese dhe vetëdijësuese për publikun.

Ministri Rashiq vlerësoi lart rolin e BQK-së dhe angazhimin e saj, duke shprehur gatishmërinë për të bashkëpunuar brenda kapacitetit të tij, me qëllim të rritjes së përfshirjes financiare dhe zgjerimit të mundësive për qasje financiare për të gjitha

komunitetet.

Ai ka thënë të mërkurën se gjatë një takimi me kryeministrin e Kosovës, Albin Kurti, janë pajtuar se rregullorja e Bankës Qendrore të Kosovës (BQK) për ndalimin e dinarit është në një periudhë tranzicioni. “Kur u takova me kryeministrin, kemi ardhur deri te një përfundim, që kjo është një periudhë tranzicioni kështu që shfrytëzuesit ta kenë një mundësi që të përgatiten për përdorimin e kësaj rregullore. Nga ana juridike dhe teknike kjo është mënyra e duhur që të vazhdojmë”, ka thënë Rashiq.

Guvernatori Ismaili dhe ministri Rashiq shprehën gatishmërinë për zgjerimin e bashkëpunimit në funksion të informimit sa më të plotë dhe adekuat për ta lehtësuar zbatimin me sukses të kërkesave të legjislacionit vendor.

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, e ka pranuar se komunikimi rreth vendimit për rregulloren e Bankës

Qendrore për pagesat vetëm me valutën euro, duke ndaluar përdorimin e dinarit serb, ka mundur të ishte më i qartë “për të shmangur konfuzion”.

Pavarësisht se rregullorja e BQK-së për pagesa me para të gatshme hyri në fuqi më 1 shkurt, mes kritikave nga faktori ndërkombëtar dhe serbëve lokalë, Kurti tha se e kupton që “një periudhë tranzicioni është e nevojshme”, duke shtuar se një periudhë e tillë tranzicioni veçse ka nisur.

Kryeministri tha se gjatë këtij muaji autoritetet do të ofrojnë informacione që “ky tranzicion të jetë sa më i lehtë që të jetë e mundur”. “Një periudhë tranzicioni kurrë nuk duhet të keqinterpretohet si sulm apo ndarje e thelluar. Dhe pasiguria e shkurtër që haset gjatë kësaj periudhe nuk duhet të shfrytëzohet për përfitimin politik”, tha Kurti, sipas një njoftimi për medie të lëshuar nga zyra e tij më 6 shkurt.

## “2024, vit i investimeve në Telekom”

**PRISHTINË, 7 SHKURT** - Kryeshefja ekzekutive e Telekomit të Kosovës, Burbuqe Hana, në emisionin “Përballje” në Telegrafi.com foli për sfidat e ndërmarjes, investimet që do të bëhen në teknologji, ristrukturimet dhe planet për vitin 2024. Ajo tha se Telekomit është në rrugë të mbarë “për t’u rikthyer si lider i shërbimeve të

telekomunikacionit në Republikën e Kosovës”.

Ajo bëri me dije se kanë nënshkruar kontratën për investime në tërë infrastrukturën e telefonisë mobile. Hana u shpreh se Telekomit për vitin 2024, sipas planit të prokurimit, parasheh investime shumë të mëdha. “Te telefonia mobile në fund të vitit 2024 do të bëhet

modernizimi i plotë i shërbimit edhe të rrjetit. Kur po them teknologjia e re i bie është teknologjia e fundit e 4G plus dhe për herë të parë Vala do të ofrojë edhe 5G-në. Kjo i bie që shërbimet e konsumatorit do të jenë cilësore. Fokusi ynë do të jetë aty çka është kërkesa e konsumatorëve”, ka thënë Hana.





# Të drogohesh për Elon Musk



Pjesëtarët e Bordit të kompanisë së prodhimit të makinave elektrike, Tesla, në pronësi të Elon Musk, janë gjendur përballë një dileme. Investitori Steve Juverston, drejtor për shumë vite bashkë me të tjerë, ishte larguar nga kompania pasi një hetim i brendshëm kishte zbuluar jetën libertine që bënte me shumë gra në sektorin e teknologjisë, si dhe përdorimin e paligjshëm të drogave.

Pasi dolën detajet e para në vitin 2017, shumë pjesëtarë të bordit i kishin kërkuar të largohej. Për fatin e tij, Juverston kishte një mik të mirë dhe të fuqishëm, i cili kishte lidhje të ngushta financiare me të dhe kish marrë pjesë bashkë me të në festa duke përdorur ekstazi dhe lsd. Ai është Elon Musk.

Në takime të rezervuara, Musk bindni këshilltarët që ta lejonin të merrte një pushim të gjatë dhe më pas të dorëhiqej vetë në vitin

2020. Në fund, ai mbeti në ekipin drejtues të SpaceX, kompania që prodhon raketa dhe që është gjithashtu nën pronësinë e Musk. Kur u pyet si bordi e kishte menaxhuar këtë rast, Antonio Gracias një tjetër ish drejtues i Tesla dhe mik i mirë i Musk, gjatë një dëshmie në gjykatë në vitin 2021 tha: "Reagim nuk pati fare, thjesht pritëm si do të shkonte". Vlerësohet se Gracias ka investuar 1.5 miliard dollarë në kompanitë e Musk. Shumë drejtorë të tjerë në kompanitë e Musk kanë marrëdhënie financiare dhe miqësore shumë të ngushta me të. Dhe kanë nxjerrë fitime të mëdha nga këto marrëdhënie. Të martën e kaluar, një gjykatës në Delaëare anuloi paketën shumëmiliardëshe të pagës për Musk tek Tesla, duke pohuar se anëtarët e Bordit që e kishin autorizuar atë paketë në vitin 2018, ishin në borxh me të. Shumë drejtues apo ish drejtues

të Tesla dhe SpaceX shkojnë në festa me të, shkojnë për pushime në vende ekzotike, marrin pjesë në festivalin e përvitshëm të "Burning Man" në Nevada. Musk dhe këta drejtues – mes tyre investitorë si Gracias dhe Ira Ehrenpreis, tekno-guruja Larry Ellison, ish drejtuesi i mediave James Murdoch, dhe vetë vëllai i tij Kimbal Musk – kanë investuar dhjetëra miliona dollarë në kompanitë e njëri-tjetrit. Disa prej tyre kanë marrë dhe mbështetje për të bërë karrierë, nga Musk. Sipas disa personave që kanë qenë të pranishëm teksa ai konsumonte substanca të ndaluara, disa menaxherë të spikatur të Tesla dhe SpaceX i njohin zakonet e tij, por nuk kanë bërë asgjë.

Në janar, Wall Street Journal shkruajti se Musk konsumon drogë, mes të cilave kokainë, ekstazi dhe lsd e kërpuha halucinogjene dhe për drejtuesit

e Tesla dhe SpaceX situata është bërë shqetësuese, sidomos kur bëhet fjalë për konsumin e ketaminës, për të cilën thotë se ka recetë mjekësore.

Në kulturën që Musk ka krijuar përreth vetes, disa miq mes të cilëve dhe drejtues, apo ish drejtues, kanë përshtypjen që ai pret prej tyre që të konsumojnë, dhe nëse nuk e bëjnë do ta shohin t'u kundërvihet. Për disa prej tyre, kjo është pothuaj njësoj si të ndihen miq të një mbreti. Musk dhe përfaqësuesi i tij ligjor, Alex Spiro nuk iu përgjigjën kërkesave të gazetarëve për komente. Spiro deklaroi se Musk u nënshtrohet periodikisht testeve antidrogë. Vetë Musk e shkroi një sqarim të tillë në X, duke shtuar se "nëse drogat do të më duheshin vërtet për të rritur produktivitetin në kohë, padyshim që do i merrja". Disa drejtues të bordit janë të shqetësuar për pasojat që sjellja e Musk do të kishte mbi kompanitë

që drejton dhe afro 800 miliard dollarë asete të investitorëve. Por pavarësisht shqetësimeve, bordi i Tesla nuk kreu hetime.

Në dimrin e 2022, Larry Ellison, mik i Musk dhe ish drejtues në Tesla, e ftoi në ishullin e tij në Hauai për t'u relaksuar dhe dezintoksikuar. Një vit më herët, Ellison e kish takuar Musk në një festë të industrisë automobilistike në Miami. Më pas, kur i bëri ofertën, ndodheshin në një festë në kodrat e Hollywood-it, ku Musk mori ekstazi në formë të lëngët nga një shishe uji që mbante në dorë. Sipas atyre që ishin të pranishëm, fillimisht truporjat e Musk kishin larguar të gjithë nga salla, për të patur pak më shumë privatësi.

Me kalimin e viteve, anëtarët e Bordit të Tesla kanë marrë qindra miliona dollarë për poltronat ku ulen, shumë më tepër se sa mesatarja në kompanitë që janë në bursë... (bota.al)



**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON  
Invert  
Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com



## Ademi: Kosova në mars do ta ketë trajnerin e ri

PRISHTINË, 7 SHKURT - Përfaqësuesja e Kosovës në futboll vazhdon të jetë pa trajner që nga shkarkimi i slovenit Primozh Gliha. Kryetari i Federatës së Futbollit të Kosovës, Agim Ademi, ka thënë se “dardanët” do ta kenë trajnerin e ri para dy ndeshjeve miqësore që

luhen në muajin mars. “Kosova do ta ketë trajnerin para fillimit të ndeshjeve të marsit. Tash për tash nuk kemi emër, por këta emra që janë përfolur nëpër medie, deri tash janë vetëm mediaë. Ne i kemi dhënë objektivat tona dhe ofertat tona, tani i presim dhe jemi duke i shqyrtuar

edhe projektet e tjera që na vijnë. Se cila do të jetë e përputhur ose e përafërt me objektivat tona, do ta zgjedhim”, ka thënë Ademi për “Klankosova.tv”. Kosova më 22 mars do të luajë si mysafire e Armenisë, ndërsa më 26 mars do të luajë po ashtu mysafire ndaj Hungarisë.



# Sonte përballen Peja - Bashkimi



**EPOKA E RE** Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 7 SHKURT - Xhiro e 21-të në Prince Caffè Superligë do të fillojë sonte (e enjte) me ndeshjen ndërmjet Pejës dhe Bashkimit. Dy ndeshje të tjera do të zhvillohen të premten dhe një të shtunën. Kjo javë pritet të jetë interesante, pasi janë ndeshjet e fundit në elitë para ndeshjeve në garën e Final 8 Kupës së Kosovës në basketboll. Ky turne zhvillohet nga 13 deri më 17 shkurt në Gjakovë. Peja, që është kampion në fuqi në basketbollin e Kosovës, është favorite në përballje me skuadrën e Bashkimit, ndërsa momentalisht zë vendin e dytë në tabelë me pesëmbëdhjetë fitore

dhe pesë humbje, ndërkaq klubi prizrenas renditet në vendin e gjashtë me shtatë fitore dhe trembëdhjetë humbje. Nesër (e premte) zhvillohen dy ndeshje nga ora 19:00. Përballje interesante do të jetë në mes të Trepçës dhe Golden Eagle Yllit, vendit të parë, përkatësisht të katërt në renditje. Mitrovicasit janë liderë me 18 fitore e dy humbje, kurse therandasit kanë 12 fitore e tetë humbje. Ndeshja tjetër që zhvillohet sot është ajo në mes të Proton Cable Prizrenit dhe Istogut. Prizrenasit janë në vendin e shtatë me pesë fitore e 15 humbje, kurse istogasit të fundit me vetëm një fitore e 19 humbje. Ndeshja e fundit për këtë xhiro

është ajo në mes të Vëllaznimit dhe Sigal Prishtinës. “Kuqezinjtë” e Gjakovës renditen në vendin e pestë me nëntë fitore e njëmbëdhjetë humbje, ndërsa “bardhekaltrit” në vendin e tretë me trembëdhjetë fitore e shtatë humbje.

**PRINCE CAFFE SUPERLIGA (JAVA 21)**

**Të enjten takohen:**  
19:00 Peja - Bashkimi

**Të premten takohen:**  
19:00 Trepça - Golden Eagle Ylli  
19:00 Proton Cable Prizreni - Istogu

**Të shtunën takohen:**  
17:00 Vëllaznimi - Sigal Prishtina

## Gjyqtarja Florentina Kallaba, kandidate për Kupën e Botës në futboll

PRISHTINË, 7 SHKURT - Gjyqtarja e futbollit, Florentina Kallaba nga Kosova, është në mesin e kandidatëve për të marrë pjesë në Kupën e Botës për Femra 2025 në futboll. Kallaba, që ka karrierë të suksesshme si gjyqtare e futbollit në Kosovë dhe në kampionate të rëndësishme evropiane të futbollit, është shprehur e lumtur dhe e gatshme për këtë sfidë të re për të. “Është krenari dhe nder i madh që të jem një nga gjyqtaret kandidate për të marrë pjesë në Kupën e

Botës në futboll për femra që do të mbahet për herë të parë nga FIFA”, ka thënë Kallaba.

Ky hap i rëndësishëm për gjyqtaren Kallaba shënon suksesin e radhës për gjyqtarët kosovarë të futbollit.

Lajmi që Florentina Kallaba është në mesin e kandidatëve për të qenë pjesë e Botërorit është mirëpritur nga zyrtarët e FFK-së, të cilët besojnë në përzgjedhjen e Kallabës në një event të tillë, duke e ditur se sa shumë kualitete ka.



## Në fundjavë kthehet Superliga e hendbollit

PRISHTINË, 7 SHKURT - Në fundjavë vazhdon gara në Superligën e Kosovës në hendboll (meshkujt). Xhiroja e 15-të është e para për këtë vit. Gara për titull të kampionit pritet të jetë shumë e fortë, dramatike dhe interesante

deri në fund. Aktualisht Rahoveci udhëheq në tabelë me 28 pikë. Skuadra rahovecase i ka fituar të gjitha 14 ndeshjet e stinorit vjeshtor. Kampionia aktuale, Besa Fungas, është e dyta me 22 pikë. Trepça është e treta me

20 pikë, ndërsa pason Kastrioti me 16 pikë dhe Prishtina me 14 pikë. Deçani, Vushtrria e Vëllaznimi janë në tri pozitave e fundit. Në afatin kalimtar të janarit është forcuar sidomos Kastrioti, që pritet të përfshihet në garë për trofe.

Ndërkohë nga Trepça janë larguar shumë lojtarë dhe mbetet të shihet si do ta përballojnë mitrovicasit këtë. Ndeshjet e xhiros së 15-të janë: Deçani - Vëllaznimi, Vushtrria - Besa Fungas, Kastrioti - Trepça, Prishtina - Rahoveci.



## Broja, transferimi i tretë më i mirë në Angli

LONDËR, 7 SHKURT - Si kurrë më parë në vitet e fundit, Premierë Liga thuhet se qendroi në heshtje këtë merkato dimri, për shkak edhe të problemeve që ka me

rregullat e "Fair Play Financiar". Një nga lëvizjet më të rëndësishme në këtë sesion ishte transferimi i Armando Brojës te Fulhami. Sulmuesi kuqezi ishte një nga

lojtarët më të lakuar në ishull, por në fund garën e fitoi ekipi londinez. Sipas një sondazhi të kryer nga "Daily Mail", Broja vlerësohet nga tifozët si lëvizja e tretë më e rëndësishme e

kryer në këtë merkato dimri. Në vendin e parë vlerësohet transferimi i Timo Werner te Tottenhami, ndërsa në vendin e dytë kalimi i Calvin Phillips te West Hami.



## Gjimshiti arrin 200 ndeshje tek Atalanta, vendos rekordin personal në Serinë A

BERGAMO, 7 SHKURT - Një titullar i padiskutueshëm, por edhe mishërimi i një rritjeje konstante që, në fakt, është ajo që kërkohet nga çdo futbollist. Berat Gjimshiti festoi fundjavën e shkuar 200 ndeshje tek Atalanta, në Serinë A, që pas transferimit të tij në sezonin 2015/2016 dhe pas dy edicionesh të kaluar, si i huazuar. Një arritje mbresëlënëse për kapitenin e kombëtares së Shqipërisë, që nuk do të ndalet këtu, ashtu siç tregon vetë në intervistën për të përditshmen "L'Eco di Bergamo". "Ëndrra e çdo futbollisti është të fitojë trofe dhe unë kam ambicie ta realizoj këtë ëndërr si në nivel klubesh, ashtu edhe me Kombëtaren time. Është mirë për mua të mos shënoj në Serinë A, të vazhdoj të shënoj në Evropë dhe t'ua lë të tjerëve golat në kampionat", ka thënë kapiteni i Shqipërisë. Jo vetëm me klubin, pasi "steka" e synimeve të Gjimshitit është e



lartë edhe me Kombëtaren "Kuçezi", duke nisur nga finalët e "Euro 2024". "Ndiej përgjegjësinë ndaj shokëve dhe të gjithë kombit që na ndjek me ngrohtësi. Të jesh kapiten i një Kombëtareje më ka dhënë besim edhe nga

perspektiva e Atalantës", u shpreh mbrojtësi shtatlartë. Në këtë sezon tek Atalanta, Berat Gjimshiti ka luajtur 28 ndeshje në të gjitha kompeticionet, ndërsa ka shënuar edhe një gol në fazën e grupeve të Ligës së Evropës.

## Clippersat marrin kryesimin në Perëndim, Milwaukee pëson ndalesën e dytë radhazi

PHOENIX, 7 SHKURT - Minnesota e Oklahoma janë mundur në ndeshjet e radhës, duke i dorëzuar kreun e renditjes në Perëndim ekipit të clippersave (ishte pushim). Minnesota u mund me rezultat 129-123 nga Chicago pas kohës shtesë, sfidë ku DeRozan dhe White realizuan nga 33 pikë secili. Oklahoma u mund me rezultat 124-117 nga Utah Jazzi, ndeshje me rivalitet, ku për vendasit u dallua Markkanen me 33 pikë e 11 rebounde. Humbja e dytë radhazi për Milwaukee, që



u mund me shifrat 114-106 nga Phoenixi. Booker me 32 pikë e Duranti me 28 bënë diferencën në parket, duke i bërë të pavlefshme 34 pikët e Antetokounmpos. Fitore në sekondat e fundit për Indianan, që falë 29 pikëve të

Siakamit, mundi me rezultat 132-129 Houstonin. Shkëlqeu edhe ekipi i Dallasit, që mundi me shifrat 119-107 Brooklynin, sfidë ku protagonist ishte dyshja Irving - Donçiq, që së bashku realizuan 71 pikë.

### Rezultatet

Indiana - Houston	132-129
Brooklyn - Dallas	107-119
Miami - Orlando	121-95
New York - Memphis	123-113
Chicago - Minnesota	129-123
Utah Jazz - Oklahoma	124-117
Phoenix - Milwaukee	114-106


## Galatasaray shënjestron Eriksenin

Galatasaray mund të nënshkruajë me mesfushorin e Manchester Unitedit, Christian Eriksen. Tabloidi anglez "Daily Mirror" raporton se klubi turk ka nisur kontaktet me Eriksenin

dhe ky transferim mund të realizohet për faktin se mesfushori po gjënjë pak hapësira në formacionin e Ten Hagenit. "Eriksenin mund të bashkohet me klubet turke që

janë ende në gjendje të nënshkruajnë lojtarë deri më 9 shkurt", shkruan tabloidi britanik. 31-vjeçari iu bashkua "Djajve të Kuq" si lojtar i lirë nga Brentfordi në verën e vitit 2022

dhe ka bërë mbi 50 paraqitje nën drejtimin e Erik ten Hagut. Danezi ka luajtur vetëm tri ndeshje në Premierë Ligë që nga mesi i nëntorit për shkak të një kombinimi lëndimesh.



### SHKURT

## Flick dëshiron ta marrë drejtimin e Barcelonës

Xavi Hernandez ka zyrtarizuar largimin nga Barcelona në fund të këtij sezoni, por e paqartë vazhdon të mbetet se kush do të jetë pasuesi i tij. Ditët e fundit janë përfolur shumë emra si zëvendësues të mundshëm të Xavit, derisa eksperti i merkatos, Fabrizio Romano, ka njoftuar se Hansi Flick mund të jetë trajneri i ri i Barcelonës. Ish-trajneri i Bayern Munchenit dhe Kombëtares së Gjermanisë ka shprehur dëshirën e tij për ta marrë drejtimin e Barcelonës. Flick është i papunë që nga momenti kur u shkarkua nga drejtimi i Gjermanisë.

## Fernandezi kërkon të largohet në verë nga Chelsea

Futbollisti Enzo Fernandez nuk është i kënaqur në klubin e Chelseat dhe po mendon të largohet gjatë verës. Argjentinasi ishte një nga transferimet më të bujshme të Chelseas në merkaton e dimrit 2023, për të cilin shpenzoi 121 milionë euro. Megjithatë, agjentët e Fernandezit po shohin mundësitë ku mund të lëvizë mesfushori, pasi nuk e sheh të pëlqyeshme vazhdimësinë te Chelsea. Futbollisti në fjalë i kushtoi Chelseat 106 milionë paund, ku u transferua nga Benfica.

## Kroosi, besnik i Realit

Mesfushori Toni Kroos është futur në muajt e fundit të kontratës me Real Madridin dhe spekulimet për të ardhmen e tij kanë qenë të shumta në ditët e fundit. Mesfushori gjerman ka vendosur t'i mbetet besnik Real Madridit së paku edhe për një vit tjetër. Ish-reprezentuesi gjerman po kalon nëpër një formë të shkëlqyer ku ka realizuar një gol dhe ka asistuar në shtatë të tjerë në 28 ndeshje zyrtare. Kroos ka dhënë miratimin e tij për kontratën e re e cila do të jetë njëvjeçare nga e cila do të fitojë 8,5 milionë euro pagë vjetore. 34-vjeçari është pjesë e Real Madridit që nga viti 2014 dhe që nga ajo kohë ka qenë një nga lojtarët kyç në suksesin e madrilenëve.

## Bashkëshortja e Alvesit dëshmon në gjyq: Ishte i dehur

Bashkëshortja e Dani Alvesit, Joana Sanz dhe tre miqtë e futbollistit pohuan në gjyq se ai ishte i dehur natën e 30 dhjetorit 2022, ku një e re 23-vjeçare e akuzon se e ka përdhunuar. Ajo ka shpjeguar se më 30 dhjetor futbollisti e kaloi ditën me miqtë në një restorant dhe se besonte se ai do të kthehej për darkë, por u kthye vetëm në orën 4 të mëngjesit, "shumë i dehur dhe me erë alkool". Kur Alvesi hyri në dhomën e gjumit, goditi komodinën dhe ra mbi shtrat, kështu që Joana nuk ishte në gjendje të fliste me të. Modelja vizitoi disa herë bashkëshortin e saj në burg, por më pas doli publikisht duke pohuar se i ka dhënë fund lidhjes, pavarësisht se ligjërisht ende nuk është bërë divorci. Për futbollistin 40-vjeçar prokurori publik ka kërkuar 9 vjet burg si dhe 150 mijë euro për dëmshpërblim për viktimën.



**NJOFTIM**

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “R&D Group” SH.P.K. me seli në Rahovec, me pronar Tahir Bala, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 810733990 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

**OBAVESTENJE**

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “R&D Group” D.O.O. Rahovec, sa vlasnikom Tahir Bala, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 810733990 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

**ANNOUNCEMENT**

We inform al customers that the limited liability “R&D Group” L.L.C. with headquarters Rahovec, with owner Tahir Bala, has come to the decision to quit its business: 810733990 the company has appointet a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.



Institucion i Arsimit dhe Aftësimi Profesional (IAAP) “Ymer Prizreni” Prizren  
e-mail: mgavazaj@hotmail.com  
Nr.tel.038/20035377  
facebook:“Ymer Prizreni”



Nr. Protokolit 117/2024

Në bazë të Rregullorës nr.01/2017,datë 02.02.2017, Ligjit NR.04/L-143, nenit 12 për Arsimin dhe aftësimin për të rritur në Republikën e Kosovës , Drejtoresha e IAAP “Ymer Prizreni” në Prizren, vendos për pranimin e nxënësve në arsimin për të rritur dhe me këtë rast publikon këtë:

**KONKURS**

**EKONOMI**

- 1.Kontabilitet e tatime..... 1 paralel 24 nxënës
- 2.Tregti me pakicë e shumicë..... 1 paralel 24 nxënës

**HOTELERI**

- 1.Asistent restoranti.....1 paralel 24 nxënës

**TEKNOLOGJI USHQIMORE**

- 1.Teknologji ushqimore.....1 paralele 24 nxënës

**ADMINISTRATË**

- 1.Administrim dhe shërbime të zyrës..... 1 paralel 24 nxënës

**Kushtet:**

Dokumentacioni (dëftesa e shkollimit paraprak,certifikata e lindjes, dhe letërnjoftimi i fotokopjuar).

Pagesa bëhet sipas rregullores së MASHT-it Nr.11/2011 Dt.:30.12.2011 dhe Rregullores për tarifa,taksa,ngarkesa dhe gjoba nga shërbimet dhe veprimtaritë komunale nr.01/11.

- 1. Për regjistrimin e vitit për një klasë: 100 €
- 2. Praktika profesionale 50 €
- 3. Lënda me shkrim dhe me gojë 10 €
- 4. Lënda me gojë 8€
- 5. Për diplomë(përfundimi i shkollimit): 50€
- 6. Provime diferenciale 10€

**Vijueshmëria në mësim**

Kandidatët e pranuar janë të obliguar që t'i ndjekin 18 javë mësimi nëse klasa e profilit përkatës numëron mbi 15 nxënës, dhe në fund t'i nënshtrohen testit vlerësues në të gjitha lëndët e parapara për arsimin për të rritur.

Për klasë ku numri i nxënësve është nën 15 nxënës, organizohet mësimi konsultativ.

**Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga dita e publikimit në gazetë.**



**Gjej PUNË**

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



[www.facebook.com/gjeipuneshpejte](http://www.facebook.com/gjeipuneshpejte)

**RESTAURANT**

**SWISS**

**TAVERNA**

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË

**>> SHPALLJE TË VOGLA <<**

- Shkumbin J. Hetemi B.I. Auto Parking Kushtrimi, shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. 811541037 si dhe Vulën e Biznesit.

- Biznesi Teuta-T SH.P.K. me nr. 810176223 nga Rahoveci, shpall të pavlefshme certifikatën e Biznesit (të humbur).

- “Swiss Corp” SH.P.K. shpall të pavlefshme certifikatën e TVSH-së, me nr. 330336596.

- Rinor Badalli shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - IX shfmu” Dëshmorët e Zhurit “ Zhure.

- Besmir Regjaj shpall te pavlefshme certifikatën Q.K “11 Marsi” Prizren.

- Labinot Jasharaj shpall te pavlefshme dëftesën e kl XIII dhe diplomën Q.K “11 Marsi” Prizren.

- Lirim Berisha shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - IX shfmu “ Leke Dukagjini “ Prizren.

- Mirela Balaj Metalijaj shpall të pavlefshme dëftesat dhe diplomën e shkollës së mesme “Hysni Zajmi”

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 Euro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

- Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë nume të tel: 049-440-466.

- Lëshoj banesën një dhomshe me qira , ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroi i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.



**MEKA**  
®  
HALAL FOOD

# TRADITË QË NGA 1992

